



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

Lënda: Njoftim për 4(katër) vende të lira pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në Rektoratin e Universitetit të Tiranës

Drejtuar: Znj. Reida Kashta
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik

Rektorati i Universitetit të Tiranës shpall konkursin **për 4(katër) vende të lira pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ, si më poshtë vijon:**

1. Përgjegjës i Sektorit të Kurrikulave, pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë;
2. Specialist në Sektorin e Kurrikulave, pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë;
3. Specialist në Sektorin Juridik, pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme;
4. Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Studentët, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët dhe Publikun.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmësakademik me karakter administrativ me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Kurrikulave”, pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme:**

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente me të. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të zotërojnë me dëshmi të paktën një nga gjuhët e huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta:**

1. Preferohen kandidatët që kanë gradë shkencore në fushën e arsimit;
2. Preferohen kandidatët me përvojë në mësimdhënie;
3. Të kenë njohuri të programeve bazë kompjuterike;
4. Të ketë njohuri të Ligjit të Arsimit të Lartë;
5. Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të dinë të punojnë në grup.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmësakademik me karakter administrativ “Specialist” në Sektorin e Kurrikulave, pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente me të. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të zotërojnë me dëshmi të paktën një nga gjuhët e huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta**:

1. Të kenë njohuri të programeve bazë kompjuterike;
2. Të ketë njohuri të Ligjit të Arsimit të Lartë;
3. Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të dinë të punojnë në grup.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmësakademik me karakter administrativ me detyrë “Specialist” në Sektorin Juridik, pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente me të në Drejtësi. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta**:

1. Preferohet të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit;
2. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në arsimin e lartë;
3. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
4. Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze, e provuar me dëshmi;
5. Të kenë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmësakademik me karakter administrativ “Specialist” në Sektorin e Marrëdhënieve me Studentët, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët dhe Publikun, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme:**

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente me të në Shkenca Shoqërore. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta:**

1. Preferohet të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit;
2. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në arsimin e lartë;
3. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
4. Të njohë me dëshmi gjuhën angleze. Njohja e gjuhëve të tjera të huaja përbën përparësi;
5. Të kenë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Curriculum vitae;
3. Diplomë e studimeve universitare (fotokopje e noterizuar). Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopja e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent;
4. Të paktën dy referenca nga punëdhënësit e mëparshëm;
5. Dëshmi penaliteti;
6. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (fotokopje e noterizuar);
7. Dëshmi që të vërtetojë njohuritë bazë të përdorimit të kompjuterit (fotokopje e noterizuar);
8. Kopje të librezës së punës (fotokopje e noterizuar);
9. Raport mjekësor për aftësinë në punë.

Dokumentat pranohen në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, **nga data 20.09.2021 - 04.10.2021**. Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

REKTORI

Prof. Dr. Artan Hoxha